

Data 01.07.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Shtypshkrime”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

42962200-9 – Shtypshkronjë

VLERA E FONDIT LIMIT: 34,677,500 (tridhjetë e katër milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH.

Në Eur: 355.011.26 (treqind e pesëdhjetë e pesë mijë e njëmbëdhjetë pikë njëzet e gjashtë) Euro, pa TVSH

**Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 01.07.2025 është 97.68
Lekë/Euro**

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “Posta Shqiptare” SH.A. ka vendosur që kjo procedure të mos jete ne lote sipas arsyetimit të mëposhtem:

Kjo kontrate nuk është ndare në lote pasi administrimi i saj, pra i gjithë bazës materiale objekt kontrate do të administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme Posta Shqiptare SH.A, si dhe ndjekja dhe zbatimi i kontratës do të bëhet nga magazina e Drejtorisë së Përgjithshme, ndarja dhe frangmentimi i saj do të krijonte kompleksitet dhe vështirësi në zbatim si dhe do të bente të pazbatueshme kontratën.

Objekti i kontratës lidhet me furnizimin e Shtypshkrimeve për 13 (trembëdhjetë) Filialet e Postes Shqiptare dhe Drejtorisë së Përgjithshme të cilat do të shpërndahen sipas kërkesave të drejtorive/sektoreve/zyrave përkatëse, si dhe çdo Filiali ,

Persa me lart ndarja ne lote do ta nderlikonte dhe veshtiresonte procesin e zbatimit te kontrates duke krijuar vonesa dhe rrjedhimisht do sillte veshtiresi per stafin kerkues te bazes materiale. Kjo kontrate nuk mund te ndahet ne lote pasi ne thelb te gjithe artikujt objekt i kontrates i perkasin te njejtës kategori produktesh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Posta Shqiptare sh.a.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit të objektit që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar). Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes

financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (ndryshuar), në kushtet kur kjo procedurë prokurimi klasifikohet procedurë e hapur. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të ulët se 39% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të ulët se 39% të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik. Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej minimalisht 7 (shtate). Për të plotësuar këtë kriter duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën jo më pak se 3 (tre) muajt e fundit të maturuara nga data e hapjes së tenderit, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore.

Për përmbushjen e këtij kriteri në fazën e ofertimit, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese të DST.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i kërkuar i punonjësve është përllogaritur duke marrë në konsideratë sasinë e mallrave të kërkuara objekt i kësaj kontrate, duke pasur parasysh edhe afatin e levrimit dhe të shpërdarjes së materialeve sipas specifikimeve teknike. Gjithashtu theksojmë se shtypshkrimet të cilat do të prodhohen sipas formateve të kërkuara, kërkojnë linjë prodhimi rrjedhimisht edhe punonjës perkates. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shpërndarjen e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë:

- makineri parapergatitje CTP (linjë e kompletuar –Computer to Plate);
- makineri shtypi në rrulë;
- makineri telefonimi;
- makineri për numërim;
- makineri palosëse
- makine qepëse me tel

Disponimi i makinerive të mesiperme të vërtetohet duke paraqitur fature blerje ose dokument zhdoganimi ose në rastin e marrjes me qira duhet paraqitur kontratë qiraje të noterizuar, etj.

Dokumentacioni i paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e qarte të makinerive/ pajisjeve të kërkuara.

Për përmbushjen e këtij kriteri në fazën e ofertimit, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST.

Autoriteti kontraktor në çdo rast i lind e drejta të verifikojë disponimin e makinerive/pajisjeve pranë vendndodhjes së makinerisë/pajisjes të deklaruar nga ofertuesi.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Kërkohen këto pajisje me qëllim prodhimin e shtypshkrimeve të cilat parashikohen të prodhohen nepermjet linjes teknologjike prodhuese. Të gjitha llojet dhe formatet e makinerive dhe pajisjeve të kërkuara janë në përputhje të plote me kërkesat dhe specifikimet teknike të mallrave/shtypshkrimeve që kërkohen të furnizohen.

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të disponojë:

- makineri dixhitale për printimin e të dhënave variabël.

Disponimi i makinerisë së mësipërme të vërtetohet duke paraqitur faturë blerje ose dokument zhdoganimi ose në rastin e marrjes me qera duhet paraqitur kontratë qeraje të noterizuar, etj.

Dokumentacioni i paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e qartë të makinerisë/ pajisjes së kërkuara.

Për përmbushjen e këtij kriteri në fazën e ofertimit, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST.

Autoriteti kontraktor në çdo rast i lind e drejta të verifikojë disponimin e makinerive/pajisjeve pranë vendndodhjes së makinerisë/pajisjes të deklaruar nga ofertuesi.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Kërkohen

keto pajisje me qëllim prodhimin e shtypshkrimeve të cilat parashikohen të prodhohen nepermjet linjes teknologjike prodhuese. Të gjitha llojet dhe formatet e makinerive dhe pajisjeve të kërkuara janë në përputhje të plote me kërkesat dhe specifikimet teknike të mallrave/shtypshkrimeve që kërkojnë të furnizohen.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” / ose ekuivalent (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Vendosja e kriterëve lidhur me certifikimet ISO bazohet në përputhje me parashikimin e nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se, Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në bazë të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., datë 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se kjo Çertifikatë duhet të jetë lëshuar nga organizma çertifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente, konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri është e bazuar në faktin që certifikatat ISO garantojnë që operatorët ekonomik zbatojnë në punën e tyre procedurë të çertifikuara ndërkombëtare për të garantuar shërbime me kualitet.

Ky kriter është përcaktuar për arsye se: ISO 9001 përfaqëson standartin ndërkombëtar unanim i njohur si standarti që i përket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë. Ky standart aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit. Kjo çertifikatë përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme të biznesit si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave të klientit.

2.3.6 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të provojë se disponon minimalisht 1 (një) makinë tip ATP (Automjet për Transport të Përzier) në pronësi, me kontratë qiraje ose formë të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, me afat kohëzgjatje për të gjithë kohën e vazhdimësisë së kontratës; për këtë duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës sipas legjislacionit në fuqi. Mjeti duhet të jetë i pajisur me dokumentacion përkatës sipas legjislacionit në fuqi (certifikatë pronësie, leje qarkullimi, siguracion mjeti dhe certifikatë e kontrollit teknik të mjetit/ SGS”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë apo mund tu vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshëm për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

2.3.7. 2.3.7. Operatori ekonomik për të provuar bardhësinë dhe të dhënat mbi gramaturën e letrës për prodhimin e shtypshkrimeve (jo për kartonin), duhet të paraqesin skedën teknike të letrës, lëshuar nga prodhuesi i letrës, me qëllim që malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të kërkuara.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen eskedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.

Kërkesa e skedës teknike ka disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike: Siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit..

Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST.

2.3.8 Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi mostra/modele për zërat 1, 4, 6 – Shtypshkrime Sherbimi Bankar Financiar; dhe për zërat 20, 23, 26.34 - Shtypshkrime Sherbimi Postar, të përcaktuara në sasinë dhe grafikun e lëvrimit dhe sipas specifikimeve teknike (sipas renditjes në Shtojcën nr. 6 të dokumenteve të tenderit) të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre me specifikimet teknike është kusht për skualifikim."

Mostrat/modelet duhet të dorëzohen të futur në zarf jo transparent të mbyllur të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën e shoqërisë, në ditën dhe orën e hapjes së tenderit përpara Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Këto modele do të kontrollohen nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Mosparaqitja e këtyre modeleve në afatin e përcaktuar dhe jo sipas specifikimeve teknike është kusht për skualifikim.

SQARIM: Operatori ekonomik duhet të dorëzojë modelet përkatëse në përputhje me specifikimet teknike.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Dorëzimi i mostrave është shumë i rëndësishëm për procesin e vlerësimit teknik dhe verifikimit të përmbushjes së specifikimeve teknike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike të procedurës për Specifikimet teknike të procedurës për “**Blerje Shtypshkrime**”, janë hartuar mbi bazën e **Urdhërit Nr. 17**, datë **02.04.2025**, të Administratorit të Posta Shqiptare sh.a., në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar).

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

VLERA LIMIT E KONTRATËS,

Vlera Limit e kontratës, duke qenë se nuk ka çmime të botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse, grupi i punës i ngritur me urdhërin e administratorit **nr. 29**, datë **12.05.2025**, u bazua në çmimet e tregut, e bazuar në nenin 76

“Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” (i ndryshuar) ku parashikohet se:

1. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe*
- b) **studimit të tregut**, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose më shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Bazuar në germen b) të pikes 1, të nenit 76 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve

Publike” (i ndryshuar), grupi i punës, ka realizuar **studimin e tregut**, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; dokumentacion i cili gjendet në dosjen e tenderit dhe ka përlllogaritur vlerën limit të kontratës.

Specifikimet teknike fondi limit dhe kriteret e vecanta per kualifikim jane hartuar nga strukture e posacme e ngritur me urdher te titullarit te autoritetit kontraktor.

Njësia e Prokurimit: